



Shkruan: Dr.Shefqet KRASNIQI

Edhe më tej po flitet e po shkruhet rreth ndalesave të cilat i aprovuan kuvendarët tanë me 29 gushtë 2011 , në parlamentin e Kosovës e që kishin të bëjnë kryesisht me çështje të fesë si edukata fetare dhe bartja e shamisë nëpër shkolla publike. Të gjithë thuajse po shkruajnë e po flasin, kush pozitiv e kush negativ, varësisht si po e shohin dhe nga cili kënd po e vështrojnë. Mjerisht shumica e shkrimeve dhe debateve janë në disfavor të shamisë dhe çdo gjëje që ka të bëjë me Islam, e për mendimin tim nuk është shumë e çuditshme, ngase shumica e tyre janë injorantë ndaj Islamit në përgjithësi, dhe ndaj mbulesës në veçanti.

Është interesat se pjesa dërmuese e atyre që po e kundërshtojnë shaminë ne shkolla publike, apo mbulesën e femrës myslimane po e lidhin atë me “arabizëm”, me “radikalizëm” , me “një veshë të re për vendin tonë” e tjerë, tjerë. E herë, herë duke e konsideruar atë si “simbol të skllavërimit të femrës”, apo “shtypjes dhe burgimit” të saj, "propagandës fetare", e deri te lidhja me "imazhin e vendit" dhe "islamin politik". Shqetësues është fakti që pothuajse të gjitha debatet ku u vene ne pah këto arsyetime të ndalesës së mbulesës ne shkolla publike qene jo produktive për faktin se mungonte matura, edukata, kultura njerëzore, qëllimi i mire dhe sinqeriteti për drejtësi.

Qasja dhe trajtimi që ju bë kësaj çështje ishte aq negative, e ngushte dhe e papërgjegjshme sa që demaskoheshin nga vet kundër argumentet e tyre. Si mund të pretendohet që luftohet ekstremizmi kur ne vend të ndërtimit të urave të njohjes reciproke, urtësisë, racionalitetit, tolerancës dhe shtrimit të rrugës së mesme përdoret gjuha e ofendimeve, e urrejtjes, islamofobisë, paragjykit, diskriminimit etj që është padyshim një ekstremizëm në vetë.

Edhe nëse vërtete janë të preokupuar me ruajtjen e laicitetit të shtetit ne të cilën shpesh thirren ku për këtë do flasim me shume javën e ardhshme inshAllah, nuk duhet ta shfaqin këtë komoditet absolut derisa janë në pyetje të drejtat elementare të njeriut. Sepse nuk duhet harruar që kushtetuta jone e garanton të drejtën e besimit dhe shpërfaqjes së saj në publik dhe kur

përmendet mundësia e kufizimit të kësaj të drejte po ashtu potencohet që kjo assesi nuk duhet të tejkalojë qëllimin e mirë ashtu që duke dashur të evitoj një "problem" të behet shkak i me shume problemeve.

Prandaj është me të vërtetë e vështirë të shpjegohet nxitimi i qeveritareve tona në këtë drejtim pa analizuar pasojat, gjë që shkakton irritim dhe mosbesim të masës e gjere që do të vuaj ato duke i lënë hapësirë përçarjes, urrejtjes, abuzimit me të drejtat e njeriut dhe thellimit të krizave të identitetit larg vlerave të diversitetit, multikulturalizmit, tolerancës dhe harmonisë së përgjithshme. Prandaj në të premtën e kaluar u patë paralajmëruar një protestë para qeverisë, nga shoqëritë civile për shkak të ndalesës së shamisë, e që si duket do të mbahet sot pas faljes së namazit të gjumasë.

E kjo jep me kuptua se vërtetë besimtarët e ndjejnë vetëm shumë të fyer, të diskriminuar në baza fetare dhe të privuar nga një pjesë e madhe e lirisë, e që është liria fetare andaj edhe duan ta shprehin atë pakënaqësi para organeve qeveritare që ta rishqyrtojnë këtë çështje të rëndësishme duke ndjekur modelin amerikan dhe atë të shumicës së vendeve perëndimore. Konsideroj se këtu nuk ka asgjë të keqe, në veçanti kur të protestuarit është legjitim edhe me kushtetutën e vendit.

E natyrisht në nuk dyshojmë në maturinë dhe urtësinë e besimtarëve, sepse arroganca dhe sjellja jo e mirë nuk i takon askujt, e më së paku besimtarëve të devotshëm. Mirëpo në nuk duam tani të flasim për pasojat e vendimeve që janë marre për mbulesën por dëshirojmë të fokusohemi me shume të historiku i mbulesës që si duket është i panjohur për shume ke.

Ajo që duhet ta kuptojmë është se mbulesa nuk është vetëm e shqiptarëve, e as vetëm e turqve, apo arabëve, bile nuk është vetëm e myslimanëve. Hulumtuesit dhe studiuesit e sinqertë mundë ta gjejnë se mbulesa është praktikuar që nga kohët e lashta ndër popuj të ndryshëm. Bile në Kuran tregohet qartë se edhe gruaja e parë –Hava- në një farë mënyre ka qenë e mbuluar me një lloj drite –nuri nga i Madhi Zot. E më pas mbulesa është përcill nëpërmjet të gjithë profetëve gjatë historisë së njerëzimit. Librat hyjnorë si Tevrati (Tora), Inxhili (Ungjilli) dhe në fund Kurani, në mënyrë të qartë urdhërojnë femrën që të mbulohet.

Tek hebrenjtë shfaqja e femrës në publik me kokë zbuluar konsiderohej gjynah, e në disa raste edhe lakuriqësi, bile femra pa mbulesë tek ta mundë edhe të ndëshkohej. Të vetmet femra të cilat nuk kishin të drejtë të mbuloheshin ishin prostitutat, në mënyrë që mos të njollosin femrat e mbuluara e që konsideroheshin të ndershme e të moralshme. E njëjta gjë ishte edhe tek të krishterët, të cilët gratë dhe bijat e tyre i urdhëronin që ta mbulonin tërë trupin, duke futur edhe kokën këtu, bile edhe fytyrën dhe zbulimi i kokës konsiderohej shenjë turpërimi dhe nënçmimi.

Dhe jo vetëm tek shoqëritë me fe qiellore që ka qenë prezentë shamia, por edhe tek shumica absolute e shoqërive tjera, për mos me thënë të gjitha shoqëritë anë e këndë botës. P.sh: në periudhën e faraonëve në Egjiptin e lashtë, femra detyrohej të mbulohej, pastaj në Romën e lashtë çdo pjesë e femrës ju mbulohej saqë as zogu i këmbës nuk i dukej. Ngjashëm ka qenë edhe në Greqinë e vjetër, pastaj në Persi, Indi dhe shoqëri tjera. E shoqëria e fundit e cila ka legjitimuar mbulesën është shoqëria islame, pra nuk e ka shpikur atë, ngase ajo veç ka qenë, por e ka bërë atë legjitime si veshje të modestisë, bile edhe obligim për çdo femër të moshërritur. Lirisht mundë të themi se mbulesa ka vazhduar të jetë si pjesë e identitetit të femrës, në veçanti

asaj myslimane, evreje dhe të krishtere me shekuj deri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit njëzet, ku femrat evropiane kanë filluar gradualisht ta heqin mbulesën.

E me përfundimin e luftës së dytë botërore mbulesa ka filluar të bëhet gati se e pa njohur dhe e huaj gjithë andej nëpër Evropë, për tu përdorur vetëm në kishë kur edhe bëhet adhurimi i Zotit. Me përjashtim të motrave të nderit (murgeshave) të cilat edhe sot e kësaj dite e kanë mbulesën ashtu siç kërkohet nga to. Kanë bërë përjashtim edhe një numër i grave të vjetra, atyre ortodokse dhe katolike të cilat deri krejt vonë para pak viteve nuk e kanë hequr mbulesën, bile diku, diku ka ende. Ndërsa tek evrenjtë mbulesa është shumë ma prezentë sesa tek gratë e të krishterëve. Edhe tek myslimanët në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit njëzetë është luftuar me të madhe mbulesa dhe kanë arritur mjaft “sukses” në këtë drejtim gjithandej nëpër botën islame.

Madje edhe tek ne shqiptarët deri në luftën e dytë botërore mbulesa ka qenë thuajse e domosdoshme, jo vetëm nga ana fetare, por edhe nga ana tradicionale, ashtu që është konsideruar marre e madhe me qenë një grua pa mbulesë. E pushteti komunist si armik i përбетuar jo vetëm i Islamit, por i çdo feje, bëri të vetën dhe na solli në këtë gjendje ku jemi ne sot.

E mos të flasim se çka na gjeti me ardhjen e “demokracisë”, ku vajzat tona thua se na u zhveshën krejt. Sido që të jetë, kush e mban e kush jo është çështje tjetër, por realiteti qëndron se shamia nuk është diçka e re tek populli shqiptar, por se ne si njerëz me përkatësi Islame duam ta mbajmë shaminë, pa u ndikuar nga asnjë kulturë apo popull, por thjesht e konsiderojmë obligim qiellor me të cilën plotësohet personaliteti i një femre.

Andaj ju lutemi mos na pengoni, sepse fundja fundjes jemi në një shtet ku të gjithë duhet ti gëzojmë të drejtat e barabarta, pa e dëmtuar askënd. E që nuk kam dyshim se këtë do ta bëjmë me emër të Allahut, herët apo vonë, inshallah sa ma shpejt